Republika e Kosovës

Republika Kosova / Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT

AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

E RAPORTIT VJETOR TË PUNËS PËR VITIN 2021

Prishtinë, AKK, prill 2022

PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE KRYESORE

KORNIZA LIGJORE & SENZIBILIZIMI	• Zbatimi i kornizës ligjore në fushën e kundër korrupsionit • Edukimi i zyrtarëve publik dhe aktivitetet vetëdijsuese për qytetarët mbi kornizën ligjore dhe mekanizmat aktual përgjegjës për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit
DEKLARIMI I PASURISË	• Rezultatet nga procesi i deklarimit dhe kontrollit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik • Përpilimi i listave të deklaruesve • Vendosja e të dhënave të deklarimeve në data-bazën e agjencisë - SDRP
ZHVILIMI I INVESTIGIMIT	• Zhvillimi i procedurave të hetimeve paraprake për rastet e dyshimit të korrupsionit • Përcjellja e kallëzimeve penale në prokuroritë kompetente • Përcjellja e kërkesave për fillimin e procedurës disiplinore për shkeljet e dyshuara administrative
KONFLIKTI I INTERESIT	• Parandalimi dhe trajtimi i rasteve të konfliktit të interesit gjatë dhe pas ushtrimit të funksionit publik të zyrtarëve të lartë publik dhe zyrtarëve të tjerë
PARANDALIMI NË PROKURIMIN PUBLIK	• Monitorimi i aktiviteteve të prokurimin publik, me qëllim të parandalimit të korrupsionit
SINJALIZIMI	• Zbatimi i ligjit dhe trajtimi i rasteve në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve
MBËSHTETJA PROFESIONALE & KOKUNIKIMI PUBLIK	• Përfaqësimi në institucionet e drejtësisë • Zhvillimi i projekteve për avancimin dhe digjitalizimin e proceseve të agjencisë • Zhvillimi i komunikimit publik
FINANCAT, PROKURIMI, DHE PERSONELI	• Administrimi i buxhetit dhe financave të Agjencisë • Zhvillimi i procedurave të prokurimit • Zhvillimi i procesit me punët e burimeve njerëzore, dhe trajnimeve

DEKLARIMET E REALIZUARA



Sipas llojit të deklarimit të pasurisë, janë realizuar 6,944 deklarime, si:

- Deklarim i Rregullt Vjetor (DRV): 4,892 deklarime;
- Deklarim me Marrjen e Detyrës (DMD): 980;
- Deklarim Sipas Kërkesës (DSK): Zero; dhe
- Deklarim pas Largimit nga Funksioni (DLF): 1,072.

REALIZIMI I DEKLARIMIT TË RREGULLT VJETOR



Statistikat e deklarimit të rregullt vjetor (DRV):

- 4,839 deklarime:
  - 4,783 deklarime brenda afatit;
  - 56 deklarime pas afatit.
- 53 mos deklarime
  - 25 mos deklarime të pa arsyetuara; dhe
  - 28 deklarime të arsyetuara.

PËRQINDJA E DEKLARIMEVE SIPAS INSTITUCIONEVE



REZULTATET E KONTROLLIT TË PLOTË



Kontrolli i plotë është realizuar për 966 raste, të përzgjedhura:

- 954 përmes hedhjes së shortit, dhe
- 12 raste ex-officio.

- 190 raste të tjera janë proceduar në instanca të tjera për mos deklarim të pasurisë; dhe
- 50 raste janë proceduar për dyshim për deklarim të rrem (të bartura nga viti paraprak).

Nga 966 rastet e përzgjedhura për kontroll të plotë, për:

- 741 është përfunduar kontrolli; dhe
- 225 janë në procedurë



INVESTIGIMI I RASTEVE



Zhvillim i procedurës hetimore paraprake për 375 raste, prej tyre:

- 314 të vitit 2021, dhe
- 61 të bartura nga viti 2020.

Procedimi i 375 rasteve:

- 150 Kallëzime penale \ informata
- 2 Shkelje administrative
- 71 Të mbyllura, dhe
- 152 Në procedurë

AKTGJYKIMET E GJYKATAVE PËR KALLËZIMET PENALE TË AKK-SË

Gjatë vitit 2021 kemi pranuar aktgjykimet nga gjykatat resepktive për 26 raste të dyshuara për korrupsion, për të cilat raste prokuroritë kompetente kanë ngritur aktakuza bazuar në Kallëzimet Penale të Agjencisë kundër Korrupsionit.

NR.	GJYKATA	AKTGJYKIM DËNUES	AKTGJYKIM LIRUES	GJITHSEJ AKTGJYKIME
1.	Gjykata Themelore PRISHTINË	9	-	**9**
2.	Gjykata Themelore PRIZREN	4	-	**4**
3.	Gjykata Themelore GJILAN	1	-	**1**
4.	Gjykata Themelore GJAKOVË	3	1	**4**
5.	Gjykata Themelore MITROVICË	5	-	**5**
6.	Gjykata Themelore PEJË	3	-	**3**
GJITHSEJ		**25**	**1**	**26**

RASTET E TRAJTUARA PËR SINJALIZIM



AKK-ja, ka pranuar 9 informacione për sinjalizim të jashtëm. Prej tyre:

- 6 janë përfunduar; dhe
- 3 janë në procedure të hetimit të sinjalizimit të jashtëm

RASTET E TRAJTUARA PËR KONFLIKT INTERESI



Gjatë vitit 2021 Agjencia ka trajtuar gjithsej 126 raste për konflikt të interesit, ku 25 prej tyre janë bartur nga viti paraprak.

Rezultatet e 126 rasteve të trajtuara, janë:

- 13 raste kanë shmangur konfliktin e interesit;
- 12 pa konflikt të interesit;
- 2 janë proceduar për hetim;
- 1 kërkesë për kundërvajtje,
- 77 opinione\këshilla\përgjigje; dhe
- 21 raste janë në procedure.

REZULTATET E PARANDALIMIT TË KORRUPSIONIT NË PROKURIMIN PUBLIK



Gjatë vitit 2021 janë trajtuar 108 raste të aktiviteteve të prokurimit publik, ku kemi rezultuar me:

- 18 opinion (të gjitha janë respektuar);
- 83 këshilla:
  - 64 janë respektuar; dhe
  - 19 nuk janë respektuar.
- 7 raste të mbyllura me raport.

PËRFAQËSIMI NË INSTITUCIONET E DREJTËSISË



Gjatë vitit 2021 janë realizuar 25 përfaqësime për rastet e iniciuara nga AKK-ja, në institucionet e drejtësisë, si:

- 6 raste në Prokurori; dhe
- 19 raste në Gjykata:
  - 7 çështje penale;
  - 12 kundërvajtje.

AVANCIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE

INFRASTRUKTURË

- Dizajnimi i rrjetit kompjuterik lokal - LAN
- Është pranuar donacioni i pajisjet të TI-së (Server, Router, Firewall, dhe Switch) nga INL & Ambasada amerikane në Prishtinë

DIGJITALIZIM

- Zhvillimi i projektit për deklarimin elektronik të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik, dhe menaxhimin e rasteve
- Testimi pilotues i platformës e-Deklarimi i Pasurisë

MENAXHIMI

- Gjenerimi i Regjistrave të deklarimit të pasurisë nga databaza – SDRP, dhe publikimi në ueb saj të AKK-së
- Zhvillimi elektronik i tërheqjes së shortit për kontrollin e plotë të pasurisë

BUXHETI & SHPENZIMET



MËSIMET E ZËNA



Rritja e transparencës	• Forcimi i bashkëpunimit me media, organizata jo-qeveritare, dhe grupe të tjera të interesit. • Përgatitja e Strategjisë për Komunikim Publik.
Digjitalizimi	• Zhvillimi dhe funksionalizimi i platformës e-Deklarimi, për deklarimin online të pasurisë. • Digjitalizimi i proceseve të punës dhe menaxhimit të të dhënave të AKK-së
Zhvillimi i metodologjive	• Metodologjia e përbashkët hulumtuese. • Metodologjia e Vlerësimit të projekt ligjeve për potencial të Korrupsionit. • Metodologjia e planeve të integritetit.
Identifikimi & Përpilimi	• Nxjerrja e udhëzuesve për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve (në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë). • Identifikimi i nevojave për trajnim të vazhdueshëm.


REKOMANDIMET E AGJENCISË PËR:
KUVENDIN
Miratimin e Ligjit të Ri për Agjencinë
Miratimin e Ligjit të Ri për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë…
Harmonizim i Dispozitat kundërvajtëse nga neni 27 i Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve me Ligjin për Kundërvajtje
QEVERINË
Kthimi i pozitave të punës të cilat ishin aprovuar me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjeve për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, dhe për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Si dhe pozitave tjera në administratën e Agjencisë
Hartimin dhe aprovimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit për periudhën 2023 – 2026
Përkrahja e AKK me hapësira të duhura të punës dhe trajtim adekuat financiar
TË GJITHA INSTITUCIONET
Caktimi i zyrtarëve kontaktues me AKK nëpër institucione, dhe ngritja e përgjegjësisë së tyre
Hartimin e Rregulloreve të brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit
Hartimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e duhur të Planeve të Integritetit të gjitha Institucioneve, duke përfshirë ndërmarrjet publike qendrore dhe lokale
Institucionet dhe ndërmarrjet publike të dërgojnë sa më shumë përfaqësues të tyre në trajnimet që organizohen në fushën kundër korrupsionit, etikës dhe integritet

Roli YT, e drejta JOTE
Thuaj **JO** Korrupsionit

Vaše uloga, Vaše pravo
Recite **NE** Korupciji

Your Right, Your Role
Say **NO** to Corruption

Agjencia kundër Korrupsionit
Rruga Shkodra Nr. 6
10000 Prishtinë
Kosovë

Tel: 0800 10 800
e-mail: info@akk-ks.org
web: www.akk-ks.org

©Besnik Dragusha, AKK